



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 207, Datë 17.08.2022

MBI
PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN KORRIK 2022

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.08.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1458 prot., date 10.08.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Korrik 2022”,

Konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. me shkresën nr. 5506 prot., datë 04.08.2022, protokolluar në ERE me nr. 1441 prot., datë 08.08.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 31,28 lekë/kWh për muajin Korrik 2022, ku janë përfshirë edhe kostot e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 5505 prot., datë 04.08.2022, protokolluar në ERE me nr. 1442 prot., datë 08.08.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 18,34 lekë/kWh për muajin Korrik 2022, ku janë përfshirë edhe kostot e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20 kV, 10 kV si dhe 6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 Janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF).
- Mbështetur në nenin 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin nr. 201 të bordit të ERE-s, datë 04.12.2017, e ndryshuar: tarifa që FMF do të aplikojë/ngarkojë te

klitent, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e lëvrimin, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit i cili vendoset nga Rregullatori. Kostot e disbalancave do të llogariten dhe faturohen nga shoqëria, në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut të Balancimit dhe akteve të tjera në fuqi.

- Në lidhje me komponentët e tjerë të përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF për muajin Korrik 2022 evidentojmë se në përputhje me nenin 9 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Korrik 2022 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike.
- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a. si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin Korrik 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për nivele tensioni për muajin Korrik 2022</i>				
KORRIK 2022		Nivelet e tensionit		
		35 kV	20/10/6 kV	
	Njësia	Çmimi	Çmimi	
CBEt	çmimi i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	26.93	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.81	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh	31.20	18.26

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Korrik 2022 do të jetë:
 - 31.20 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
 - 18.26 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

- Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Korrik 2022, prej:

- *31,20 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV*
- *18,26 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV*

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI